

Thirrje për Shprehje Interesi

LISTA E EKSPERTËVE

Nr. i Referencës 19 – 006 - S4J

Data e Lëshimit: 14 gusht 2019
Afati i Dorëzimit: 10 Shtator 2019

1. Historiku

'Aftësi për Punë' (S4J) është një projekt i [Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim \(SDC\)](#), i zbatuar nga [Swisscontact Albania](#). Ai është pjesë e Fushës së Zhvillimit Ekonomik të Strategjisë Zvicerane të Bashkëpunimit për Shqipërinë (2018-2021), me fokus të veçantë të ***promovimi i mundësive për punësim dhe zhvillimin e aftësive***.

Projekti është në fazën e tij të dytë, e cila filloi në muajin prill 2019 dhe do të zgjasë deri në muajin qershor të vitit 2023. Gjatë kësaj faze, projekti synon të mbështesë 10,000 nxënës dhe 6,000 kursantë.

'Aftësi për Punë' (S4J) u konceptua si një projekt që ka për qëllim adresimin e sfidave në sistemin e arsimit dhe formimit profesional (AFP), si: *cilësia dhe statusi i dobët, financimi i pamjaftueshëm, orientimi i dobët drejt tregut të punës, angazhimi i dobët i sektorit privat dhe performanca e ulët e të diplomuarve në tregun e punës*. Projekti i adreson këto sfida duke u fokusuar në sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimit të kapaciteteve dhe fuqizimit të aktorëve kryesorë. Bazuar në këtë qasje, gjatë Fazës II të projektit S4J ofruesit e AFP në Shqipëri do të mbështeten për zhvillimin e fushave të mëposhtme:

- Marrëdhëniet me punëdhënësit dhe partnerët
- Diversifikimi i ofertës së AFP-së
- Mënyrat e Reja të Të Nxënës Gjithëpërfshirës
- Të Nxënës Nëpërmjet Punës në bashkëpunim me punëdhënësit, dhe
- Zhvillimi Organizativ

Të Nxënës Nëpërmjet Punës, përdorimi i *teknologjisë* në klasë, mësimi i *kombinuar dhe i individualizuar*, përshtatja e ofertës së AFP-së me nxënës, trajnimet për *standardet e industrisë* dhe aplikimi i *mendësisë së biznesit* në drejtimin e institucioneve të AFP-së janë në thelbin e punës për zbatimin e projektit "Aftësi për Punë" (S4J).

Projekti përqendrohet në sektorët e ekonomisë me potencial për rritje dhe hapjen e vendeve të punës. Aktualisht, në pesë rajonet e përzgjedhura numri i ofruesve që përfitojnë nga ky projekt është shtatë. Ata janë: [shkolla profesionale 'Hamdi Bushati' në Shkodër](#), [shkolla profesionale 'Kolin Gjoka' në Lezhë](#), [shkolla elektro-teknike 'Gjergj Canco' në Tiranë](#), [shkolla profesionale 'Kristo Isak' në Berat](#) dhe [shkolla Tregtare](#), [shkolla Industriale 'Pavarësia'](#) dhe [Qendra e Formimit Profesional në Vlorë](#). Gjatë fazës së dytë projektit do t'i bashkohen edhe katër ofrues të tjerë të AFP-së. Në të njëjtën kohë, nga nismat e pilotuara nga projekti në shkollat partnere gjatë fazës së parë do të përfitojnë edhe disa ofrues të tjerë publikë.

2. Qëllimi

Gjatë fazës së dytë (deri në muajin qershor 2023) mbështetja e projektit do të shtrihet edhe tek disa ofrues të tjerë të AFP-së në të gjithë Shqipërinë. Për të siguruar zbatimin sa më të lehtë të strategjisë dhe të aktiviteteve kryesore të parashikuara në dokumentin e projektit, ne jemi duke kërkuar bashkëpunëtorë që mund të na ndihmojnë për këtë qëllim. Këtë herë ne jemi në kërkim të individëve me njohuri dhe ekspertizë në një sërë fushash. Nëse mendoni se nuk keni lidhje me zhvillimin e aftësive, na besoni, mund të befasoheni edhe vetë. Lexojeni këtë informacion deri në fund dhe pastaj merrni një vendim. Aplikoni! 😊

Lista e ekspertëve tanë do të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar pasurimin e saj me ekspertët më të mirë në treg. Nëse jeni të interesuar të punoni me ekipin drejtues të projektit për të mbështetur hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve dhe/ ose drejtpërdrejt me ofruesit për të mbështetur përshtatjen dhe përsosjen e proceseve dhe instrumenteve, Aplikoni!.

***Kini parasysh:** përfshirja në këtë listë nuk përbën asnjë lloj detyrimi për Swisscontact-in lidhur me kontraktimin.*

*Vendndodhja: Për zbatimin e projektit 'Aftësi për Punë' Swisscontact zbaton një qasje rajonale që përqendrohet në rajonet e Tiranës, Vlorës, Lezhës, Shkodrës, Beratit dhe Elbasanit. Prandaj, **ne jemi të interesuar të gjejmë konsulentë që veprojnë në këto rajone** dhe që janë të gatshëm të udhëtojnë drejt këtyre rajoneve për detyra specifike.*

3. Kërkesat për Kualifikime dhe Përvojë

3.1 Arsimi

Ne besojmë tek njerëzit që synojnë vetë-zhvillimin. Ne jemi në kërkim të atyre personave që kanë përjetuar një udhëtim interesant arsimor që mund t'i shtojë vlerë projektit, palëve të interesit dhe përfituesve të tij. Mesazhi më i rëndësishëm që duam të transmetojmë është që përvoja arsimore e dikujt është gjithmonë e rëndësishme për punën tonë zhvillimore. Sigurohuni që të nënvizoni dhe të nxirrini në pah rëndësinë dhe lidhjen e formimit tuaj me punën e projektit, në mënyrë që ta kemi më të lehtë për t'iu dalluar nga të tjerët.

3.2 Përvoja dhe Aftësitë

Ju lutemi kini parasysh që, nëse shprehni interesin tuaj për të bashkëpunuar me ne, ju duhet të specifikoni fushat në të cilat mund të jepni kontributin tuaj. Në këtë rast, ju duhet të specifikoni qartazi lidhjen midis përvojës dhe aftësive tuaja me fushën e ekspertizës ku mendoni se mund të kontribuoni. Ne besojmë që personat që do të shprehin interesin e tyre për të bashkëpunuar me ne do të jenë të shumtë. Ju lutemi na ndihmoni që t'ju identifikojmë sa më lehtë.

Lista jonë është e hapur për të gjithë. Ne jemi në kërkim të personave që mund të përfshihen në disa detyra dhe fusha veprimtarie që nuk kërkojnë domosdoshmërisht përvojë pune të

mëparshme, por arsimim të mirë. Në disa raste të tjera, ne jemi në kërkim të profesionistëve të rinj në moshë dhe të motivuar që kanë spikatur në punët e tyre të mëparshme pa marrë parasysh gjatësinë e listës së tyre të kualifikimeve. Meqenëse puna jonë për të promovuar proceset transformuese në institucionet e AFP-së dhe për të promovuar ndryshimin sistematik në sistemin e AFP-së është mjaft e ndërlikuar, na duhen sa më shumë ekspertë të lartë me përvojë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ejani!

3.3 Aftësitë Gjuhësore

Një pjesë e punës tonë kërkon njohuri të moderuar të gjuhës shqipe. E njëjta gjë vlen edhe për gjuhën angleze dhe / ose gjermane. Megjithatë, gjatë një pjese të konsiderueshme të punës tonë kërkohet që personat e angazhuar të flasin dhe të shkruajnë gjuhën shqipe SHUMË MIRË. Në disa raste, zotërimi i gjuhës angleze në nivel të lartë është domosdoshmëri. Në rastet kur bashkëpunëtori duhet të shkruajë raporte dhe dokumente të formave të tjera, ne do të zgjedhim vetëm ata persona që kanë nivel maksimal të aftësive në shkrim dhe prezantim.

4. Fushat e Demonstruara të Ekspertizës

Më poshtë ju ofrojmë informacion në lidhje me fushat e ekspertizës për të cilat është i interesuar projekti.

4.1 Marrëdhëniet me Punëdhënësit dhe Partnerët

Projekti S4J në Fazën I promovoi me sukses një qasje të re në marrëdhëniet me punëdhënësit dhe marrëdhëniet me partnerët, duke aplikuar qasjen individuale (1:1), duke krijuar një rrjet rreth çdo ofruesi të AFP-së. Qasja 1: 1 është përshtatur me realitetet ekonomike në Shqipëri dhe mbështetet tek mësimet e nxjerra nga shumë përpjekje jo të suksesshme në projekte të tjera për të vendosur marrëdhënie me sektorin e organizuar privat. Ofruesit e AFP-së marrin përsipër rolin e tyre si pika fokale të rrjetit, dhe gjatë fazës II do ta forcojnë këtë rrjet duke e strukturuar dhe formalizuar atë, dhe duke shtuar në rrjet edhe partnerë të tjerë që nuk janë kompani, duke përfshirë sektorin e organizuar privat (ku ka interes të mirëfilltë për AFP-në), aktorët e qeverisjes vendore dhe kombëtare, prindërit, duke aplikuar të njëjtën qasje 1:1. Aty ku ofruesit në një rajon janë aktivë ata do të bashkojnë forcat me ofruesit e tjerë të AFP-së për krijimin, zgjerimin dhe / ose konsolidimin e rrjeteve përkatëse. Sidoqoftë, qasja 1: 1 tani do të zhvillohet më tej në nivel rajonal nëpërmjet krijimit të platformave rajonale të AFP-së që do të sjellin së bashku të gjithë aktorët përkatës për zhvillimin e mëtejshëm të AFP-së në rajon.

Fushat e ekspertizës:

- Dijebërje/ njohuri praktike në fushën e marrëdhënieve me biznesin si dhe në fushat e ndërlidhura me të, ekspertizë në mjedisin B2B, aftësi për të kuptuar dhe arsyetuar në lidhje me biznesin rajonal / vendor shqiptar
- Ekspertizë në vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve me biznesin bazuar në objektiva dhe tregues
- Profesionistë me përvojë në ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve me aktorët e sektorit privat / bizneseve lokale, partnerët dhe komunitetin

4.2 Diversifikimi i Ofertave të Ofruesve

S4J do të lehtësojë zhvillimin e ofertave të AFP-së cilësore, të orientuara nga tregu i punës dhe me ndjeshmëri gjinore, ofertave formale dhe joformale, të gjata dhe të shkurtra në sektorë që kanë kërkesë të lartë në ato rajone ku ushtrojnë aktivitetin e tyre ofruesit. Këto oferta do të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit vendorë dhe rajonalë dhe me zyrat e SHKP-së. Ofertat mund të përfshijnë Hoteleri-Turizmin, Ndërtimin, Tekstilin dhe TIK-un, ose do të shkojnë përtej këtyre sektorëve fillestarë kyç për projektin S4J. Ofertat do të zhvillohen për nivelet përkatëse të kualifikimit. Ato aplikojnë modalitetet e ofrimit - aty ku është e nevojshme, duke përfshirë edhe qasjet e moduluara - që plotësojnë nevojat dhe mundësitë e grupit të synuar. Prandaj, shkollat e mbështetura të AP-së do të shndërrohen në ofrues shumëfunksionalë, gjë që e ndryshon në thelb natyrën e funksionimit të tyre. Përveç drejtimeve, profileve apo kurseve, projekti do të mbështesë ofruesit e AFP-së edhe për shtimin e elementeve të tjerë të rëndësishëm në ofertën e tyre, përkatësisht nëpërmjet ofrimit të paketave për përfundimin e aftësive sipërmarrëse dhe personale (të buta) dhe të aktiviteteve jashtëshkollore që lidhen me tregun e punës.

Fushat e ekspertizës:

- Ekspertizë ligjore në fushën e arsimit dhe formimit profesional fokusuar tek oferta e AFP-së
- Zhvillim kurrikulash
- Parashikimi dhe përputhja e ofertës dhe kërkesës për aftësi
- Parashikime dhe analiza të tregut të punës
- Identifikimi i nevojave për aftësi
- Vlerësimi i nevojave për aftësi
- Trajnim për aftësitë personale (të buta), përfshirë aftësitë për sipërmarrjen
- Orientimi dhe këshillimi në karrierë
- Angazhimi i palëve të interesit
- Zhvillimi i kapaciteteve për hartimin e kurrikulës formale dhe joformale

4.3 Mënyrat e Reja të Të Nxënësve Gjithëpërfshirës

Gjatë fazës së dytë, do të zhvillohen më tej një sërë modelesh për zbatimin e mësimin të kombinuar, duke u përqëndruar tek ato modele që kërkojnë më pak akses në infrastrukturën e TI-së. Kjo përkthehet në një qasje të mësimin të kombinuar që kontribuon për të siguruar atraktivitetin e ofertave të AFP-së dhe i bën ofertat e AFP-së më të arritshme në të njëjtën kohë, edhe për grupet me nevoja të veçanta. Së bashku me trajnimet ri-aftësuese për mësuesit e AFP-së të drejtuara nga industria, edhe qasja e re bën që trajnimet në AFP të jenë më relevante për tregun e punës pasi kjo qasje e re e të nxënësve mbështet zhvillimin e aftësive personale (të buta) si zgjidhja e problemeve, puna në ekip dhe të menduarit kreativ dhe novator, që janë thelbësore për suksesin në tregun e punës dhe e mbështesin Shqipërinë në konkurrencën e saj në nivel ndërkombëtar.

Fushat e ekspertizës:

- Trajnimi i mësuesve & zhvillimi profesional

- Metodatat e mësimdhënies me në qendër nxënësin (p.sh. të nxënimit nëpërmjet lojërave, të nxënimit nëpërmjet projekteve)
- Zhvillimi i materialeve mësimore (për mësuesit dhe nxënësit)
- Teknologjitë e reja që mbështesin mësimdhënien & të nxënimit
- Lehtësues trajnimesh
- Konkurse për nxënësit dhe aktivitete jashtëshkollore
- Hulumentimi i veprimeve (për përmirësimin e metodave dhe qasjes) në arsim
- Zhvillimi sistematik i specifikave mësimore (*Instructional design*)
- Zhvillimi i materialeve mësimore digjitale (ueb dhe media)
- Administrimi i platformës së të nxënimit virtual (*Moodle*) (në nivel specialisti)
- Zhvillues i platformës së të nxënimit virtual (në nivel specialisti)
- Mbështetje nëpërmjet TI-së për pajisjet dhe sistemet (në nivel specialisti / ndihmësi)
- Vlerësimi i (rrjetit) TI (në nivel ekspert)
- *BYOD* (Sillni paisjen tuaj) dhe modele të tjera të qasjes në TI për të mbështetur procesin e të nxënimit
- Infrastruktura arsimore
- Gjinia në arsim
- Edukimi gjithëpërfshirës

4.4 Të Nxënimit Nëpërmjet Punës (WBL) me Punëdhënësit (linja 4 e ndërhyrjes)

Në kuadrin e linjës 4 të ndërhyrjes, projekti S4J do të vazhdojë të forcojë dhe zgjerojë nismat e tij të suksesshme në lidhje me të nxënimit nëpërmjet punës (WBL), duke mbështetur partnerët shqiptarë në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë shqiptare dhe projektin SD4E të zbatuar nga UNDP për të konsoliduar, rritur dhe modernizuar qasjen e zgjedhur për të nxënimit nëpërmjet punës duke përfshirë zgjidhje të tilla si skemat për zhvillimin gradual të aftësive, stazhet e punës (*internships*) dhe praktikatat profesionale afatgjata (*apprenticeships*). Skemat e praktikave profesionale afatgjata do të vazhdojnë të përmbushin standardet ndërkombëtare të cilësisë, përkatësisht standardet e ILO-s dhe të BE-së për praktikat profesionale sa më cilësore. Kompanitë do të marrin mbështetjen e nevojshme - trajnim dhe instrumente - për të siguruar stazhe pune dhe praktikat profesionale cilësore, duke përfshirë edhe trajnimin e mentorëve në kompani. Projekti i mbështet partnerët shqiptarë në zhvillimin e mekanizmave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë për të siguruar praktikat profesionale cilësore, duke garantuar standarde të cilësisë në momentin që qasja do të vazhdojë të aplikohet edhe përtej kontrollit të projektit.

Fushat e ekspertizës:

- Marrëdhëniet me Biznesin | B2B | Shitjet & Marketimi
- Burimet njerëzore | Rekrutimi
- Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së planifikimit të të nxënimit nëpërmjet punës
- Hartimi i modaliteteve të të nxënimit nëpërmjet punës sipas industrive për të rinjtë dhe të rriturit
- Hulumentimi me përvojë të mëparshme në Studimin e Tregut | Industrinë arsimore

- Ekspertizë në hulumtim: Vlerësimi dhe rishikimi i grupeve të ndryshme të instrumenteve dhe proceseve të të nxëniet nëpërmjet punës
- Ekspertizë në fushën e Zhvillimit Arsimor dhe konkretisht në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional duke u fokusuar tek tregu i punës
- Trajnim dhe lehtësim

4.5 Zhvillimi Organizativ

Rezultatet e zhvilluara në përputhje me linjën 5 të ndërhyrjes kryesisht bëjnë të mundur që ofruesit e AFP-së të performojnë më mirë *së brendshmi*, të jenë të organizuar dhe të përgatitur për funksionet e reja të përcaktuara në ligjin e ri të AFP-së dhe të zhvilluara me mbështetjen e projektit tek ofruesit partnerë gjatë fazës I. Ndër elementët e rëndësishëm mund të përmendim orientimin strategjik të ofruesve të AFP-së përfshirë strukturën e tyre organizative strategjike (strategjinë e ofruesit, përbërjen e bordit, funksionet dhe proceset e reja dhe të ndryshuara), funksionalitetet e menaxhimit të bazuar në TI, të shtatë funksionet që u janë dhënë të ashtuquajturave njësi zhvillimi dhe sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e përgjithshëm dhe specifik të ofruesve, duke u siguruar që cilësia të kthehet në një çështje të përbashkët dhe të jetë pjesë e punë së përditshme për të gjithë anëtarët e ofruesve. Në mbështetje të funksioneve të Njësisë së Zhvillimit, projekti do të mundësojë edhe zhvillimin e mjediseve dhe instrumenteve novatore tek ofruesit e AFP-së për futjen dhe integrimin në tregun e punës, veçanërisht sa i takon zhvillimit të karrierës dhe masave për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, si meshkuj ashtu edhe femra. Ata do të përfitojnë nga ndërhyrjet e hershme për të siguruar integrimin e tyre të suksesshëm në tregun e punës; skemat e synuara të këshillimit dhe instrumentet orientuese të thjeshta për kursantët për zhvillimin e kompetencave të tyre dhe për të bërë përpara me sukses në rrugëtimin e tyre drejt punës.

Fushat e ekspertizës:

- Menaxhimi i ndryshimit
- Autonomia institucionale dhe financiare e institucioneve publike
- Marketimi dhe promovimi institucional
- Mentorimi dhe këshillimi për lidhshirë
- Mënyrat e komunikimit ndërmjet ekipeve dhe brenda institucioneve - kohezioni i brendshëm midis ekipeve
- (Ri)strukturimi organizativ - përfshirë rishikimin e rregulloreve të brendshme dhe termave të referencës për secilin anëtar të stafit
- Funksionimi i brendshëm i institucioneve arsimore
- Buxhetimi i institucioneve publike - sektori i AFP-së
- Harmonizimi i kuadrit ligjor - me fokus sektorin e arsimit / AFP-së
- Planifikimi strategjik (fokusuar tek rezultatet) - duke përfshirë edhe planet e veprimit
- Psikologjia - e fokusuar tek arsimit (dhe shkolla e mesme)

4.6 Monitorimi dhe Matja e Rezultateve

Swisscontact e konsideron Monitorimin dhe Matjen e Rezultateve (MMR) si një funksion thelbësor në menaxhimin e projektit, i cili mundëson orientimin, nxjerrjen e mësimëve dhe vendos përgjegjësitë për donatorët dhe partnerët. MMR përfshin monitorimin e performancës, vlerësimin e rezultateve si dhe vlerësimin e impaktit. Për këtë qëllim, MMR përbëhet nga proceset, elementet, mjetet e menaxhimit dhe sigurimi i cilësisë. Swisscontact ka krijuar ekspertizën e tij me standardet e DCED-së, e cila gjithnjë e më shumë po njihet si praktikë e mirë ndërkombëtare. Kjo do të kontribuojë në zbatimin me cilësi të lartë të projektit S4J dhe do të ruajë besueshmërinë dhe vlerësimin nga partnerët. Gjatë fazës së dytë, S4J, si pjesë e strategjisë së saj të përshkallëzimit të mëtejshëm, do të krijojë një sistem të shëndoshë për Menaxhimin e Njohurive dhe Përmbajtjes. Procesi i përshkallëzimit të S4J varet në mënyrë të konsiderueshme nga evolucioni i produkteve dhe proceseve të projektit të mundësuar përmes veprimit dhe të nxënit nga të ngjashmit, identifikimit të praktikave më të mira dhe shkallëzueshmërisë së këtyre praktikave më të mira përmes dokumentimit dhe propagandimit.

Fushat e ekspertizës:

- Hulumtimi dhe / ose matja e rezultateve
- Projektimi i hulumtimit që mbështet menaxhimin e projektit
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave (sasiore dhe cilësore)
- Hulumtimi i veprimeve (për përmirësimin e metodave dhe qasjes)
- Menaxhimi i njohurive dhe përmbajtjes
- Planifikimi dhe organizimi i logjistikës së sondazhit, përfshirë hartimin dhe zbatimin e protokolleve për të siguruar të dhëna me cilësi të lartë
- Teknikat e intervistimit
- Përgatitja e bazës së të dhënave, menaxhimi i të dhënave dhe statistikave
- Programet statistikore kompjuterike
- Zhvillimi i dokumenteve dhe rekomandimeve të politikave
- Raportimi dhe komunikimi

4.7 Komunikimet për Zhvillim dhe Marketimi Digjital

Gjatë fazës së dytë të projektit S4J, përpjekjet në rritje do të përqendrohen në "Rritjen e ndërgjegjësimit" si në nivel horizontal ashtu edhe në atë vertikal. Qëllimi është që, përmes një qasje proaktive dhe pjesëmarrëse, të përfshihet një numër gjithnjë e më i madh i aktorëve dhe palëve të interesuara në nivele të ndryshme si promovues dhe mbështetës të AFP-së. Kjo do të ndihmonte dhe aprovonte qasjen lehtësuese të projektit. Për t'i dhënë shtysë rritjes së ndërgjegjësimit, projekti do të kalojë nga komunikimi institucional (një qasje e ndjekur gjatë fazës së parë) drejt komunikimit për zhvillim (C4D). C4D është një formë komunikimi e cila bën të mundur që njerëzit dhe aktorët e përfshirë të kenë të drejtë të ngrenë zërin, të marrin pjesë dhe të zhvillojnë ndjenjën e pronësisë mbi projektin dhe të forcojnë aftësitë rajonale dhe kombëtare.

Fushat e ekspertizës:

- Hartimi i strategjisë së komunikimit

- Mbulimi mediatic
 - a. gazetar, njoftim për shtyp, intervista, shpërndarje në media
 - b. *Livestreaming* në mediat sociale
- Shërbime Kreative & Multimedia
 - a. Dizajn
 - b. Fotograf
 - c. Prodhim videosh
 - d. Aftësi për Shkrim, Intervistim, Korigjim, Përkthim
 - e. Gazetar për të kryer intervista në terren për qëllime komunikimi

5. Kualifikueshmëria

Kjo "Thirrje për Shprehje të Interesit" është e hapur për individët konsulentë.

6. Dorëzimi i Shprehjes së Interesit

Të gjitha aplikimet do të dorëzohen në një kopje elektronike të nënshkruar tek al.info@swisscontact.org deri më **10 shtator 2019, ora 15:00**. Aplikantët e interesuar mund t'i dërgojnë pyetjet e tyre tek al.info@swisscontact.org deri më 2 shtator 2019, ora 17:00. Afati i kthimit të përgjigjeve do të jetë data 4 Shtator 2019, ora 17:00. Në rreshtin e lëndës së email-it tuaj që do të dërgohet në llogarinë e mesipërme të postës elektronike DUHET t'i referoheni fushës (fushave) të aplikuara të ekspertizës (ref. 4.1 deri 4.7). Të gjithë aplikantët do të marrin një përgjigje me anë të së cilës do t'u konfirmohet marrja e aplikimit të tyre.

Dokumentet që vërtetojnë arsimin dhe dosjet përkatëse mund të paraqiten në gjuhën angleze ose shqipe. Dokumentet në gjuhë të tjera, përveç gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe, do të eliminohen automatikisht nga Swisscontact-i pa ndonjë kërkesë të mëtejshme për sqarim dhe / ose plotësim të dokumentacionit

6.1 Dokumentet që duhen përfshirë

Konsulentët e interesuar duhet të paraqesin dokumentet / informacionet e mëposhtme për të vërtetuar kualifikimet e tyre:

- (i) CV (jetëshkrimi)
- (ii) Letra e shprehjes së interesit ku shpjegoni arsyen përse jeni kandidat i përshtatshëm për Listën e Ekspertëve, duke përfshirë fushën e interesit dhe nën-fushat përkatëse
- (iii) Tarifa ditore për konsulencën në franga zvicerane (CHF), përfshirë taksën

7. Procesi i Përzgjedhjes

Aplikimet (Shprehja e Interesit) do të rishikohen nga një komision vlerësimi në bazë të kërkesave minimale të kualifikimit. Aplikantët që plotësojnë kërkesat minimale të kualifikimit teknik (kalon / nuk kalon) do të përzgjidhen dhe do të bëhen pjesë e një liste të shkurtër. Kandidatët e kësaj liste do të renditen në secilin grup, bazuar në një rezultat që merr parasysh profilin teknik dhe ofertën financiare. Negociimet në lidhje me tarifat ditore janë të mundshme. Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen dhe nëse arrihet një marrëveshje, atëherë të dyja palët do të nënshkruajnë një Marrëveshje Kuadër. Bashkëpunëtorët individualë do të njoftohen në periudha të ndryshme

kohore, sipas nevojave të projektit. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër nuk garanton angazhimin në konsulencë.

8. Kriteret e Vlerësimit

Vlerësimi do të bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Profili teknik
- Lidhja me fushat përkatëse të ndërhyrjes së projektit
- Propozimi financiar (tarifë ditore)